

UDHËZIM
Nr. 15, datë 16.4.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 3.8.2016, “PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 1, të kreut III, termi “Diplomën¹” të bëhet “Diplomën”;

2. Në kreun II dhe në pikën 1, të kreut III, shprehjet “Ministria e Arsimit dhe Sportit” dhe “MAS” të zëvendësohen me “Qendra e Shërbimeve Arsimore” dhe “QSHA”;

3. Në pikën 1 të kreut IV, fjalia e fundit: “Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse formulari i aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim aty. Në këto raste dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me *e-mail*”, të ndryshohet si më poshtë:

“Në rast të mangësive në dokumentacion, aplikantit i kërkohet fillimisht plotësim dokumentacioni me anë të postës elektronike, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të aplikimit në QSHA. Në rast të mosdepozitimit të plotësimeve brenda katër javëve, aplikantit i kërkohen plotësime për herë të dytë me shkresë zyrtare, të cilat duhet të depozitohen brenda katër javëve në QSHA, në të kundërt praktika depozitohet në arkivin e QSHA-së dhe aplikanti duhet të bëjë aplikim nga fillimi.”.

4. Në pikën 4.1, të kreut IV, të shtohen fjalitë si më poshtë:

“Konfirmimi i autenticitetit kërkohet me *e-mail* tek IAL-ja përkatëse të paktën dy herë dhe, në rast mospërgjigjeje, konfirmimi kërkohet me shkresë zyrtare. Në rast se pas gjashtë muajve nga momenti i kërkesës së konfirmimit me shkresë zyrtare ende nuk ka një përgjigje nga IAL-ja, praktika përkatëse depozitohet në arkivin e QSHA-së.”.

5. Pika 5.1, e kreut IV, të riformulohet si më poshtë:

“Për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave, të lëshuara në përfundim të programeve të studimit që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradës shkencore “doktor”, ngrihet Komisioni i Njohjes së Diplomave.”.

6. Në pikën 5.2, të kreut IV, të shtohet:

“Në zbatim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në përcaktimet e shkronjës “b”, të nenit 75 dhe pikës 2, të nenit 124, të ligjit nr. 80/2015:

i) Diplomati e fituara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, përpara aplikimit të sistemit të Bolonjës në Shqipëri, të lëshuara deri në vitin 2010, me kohëzgjatje normale minimale 4 vjet (8 semestra), me kohë të plotë, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofroreshin në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në të njëjtën periudhë kohore.

ii) Diplomati e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, për programet e studimit të cilat përmbajnë të paktën 300 ECTS, me kohëzgjatje normale minimale 5 vite akademike, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofrohen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.”.

7. Pika 6, e kreut IV, ndryshohet si më poshtë:

“Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit (me përjashtim të gradave shkencore dhe titujve akademikë):

a) Lëshohet nga QSHA-ja (nënshkruhet nga titullari i QSHA-së dhe kryetari i Komisionit të Njohjes) në dy kopje origjinale (njëra kopje i bashkëngjitet procesverbalit përkatës dhe ruhet në dosjen e aplikimit përkatës);

b) Përmban minimalisht elementet e më-poshtme:

i) Emrin dhe mbiemrin e kandidatit;

ii) Institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën;

iii) Shtetin përkatës;

iv) Numrin e krediteve ECTS (nëse mund të përcaktohet);

v) Emërtimin e plotë të programit të studimit;

vi) Kohëzgjatja e programit të studimit;

vii) Data e përfundimit të studimeve;

viii) Njësimin e diplomës/certifikatës në Republikën e Shqipërisë;

c) Formulimi grafik i vërtetimit të njohjes dhe të njësimit përcaktohet nga struktura përkatëse në QSHA.”

8. Kreu VII të ndryshohet si më poshtë:

“Aplikanti ka të drejtë të bëjë ankimim me shkrim drejtuar Komisionit të Njohjes së Diplomave, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit (publikimit) të vërtetimit të njohjes dhe të njësimit, për njohjen e diplomave të niveleve 5 deri 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, me përjashtim të njohjes së gradës shkencore “doktor” dhe titujve akademikë për të cilët i drejtohet komisionit *ad hoc* përkatës. Ankesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbi të cilin mbështeten pretendimet e ankuesit. Afati i ankimit dhe i kthimit të përgjigjes për ankesën u referohet përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.”

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla